

DOKUMENT POZICIONUES LIDHUR ME MASAT EKONOMIKE NË KOSOVË KUNDËR COVID-19

PRISHTINË, VJENË, CYRIH, MË 14 MARS 2020

AUTORËT:

KUJTIM DOBRUNA, HAMËZ MORINA, DURIM HOXHA,
HANA TAHIRI, BARDHYL SALIHU



eciKS | Prishtina
Vienna
Zürich
Management Consulting

1. Dimensionimi global i krizës

Përhapja e virusit Corona (COVID-19), e kombinuar me rënien drastike të çmimit të naftës dhe të vlerave të aksioneve nëpër bursat tregtare, mund të sjellë ekonominë botërore në një recesion të ri. Fillimisht në Kinë, tani edhe në ekonomitë tjera të fuqishme të botës, përfshirë ShBA-të, BE-në, Japoninë dhe Korenë e Jugut, kjo krizë është duke shkaktuar dëme serioze ekonomike. Ekspertët e OECD në vlerësimet e tyre të para llogarisin me një rënie të mundshme ekonomike në nivel global prej 0.5 deri në 1.5 %.

Sfidë kryesore mbetet gjithandëj parandalimi i përhapjes së shpejtë të virusit në mënyrë që institucionet shëndetësore të mos kollopsojnë për shkak të fluksit të madh të pacientëve.

Kriza po dëmton si anën e ofertës ashtu edhe atë të kërkesës, që si rrjedhojë ka uljen e aktivitetit ekonomik dhe rënien e investimeve. Në kohëra krizash investimet ua lëshojnë vendin kursimeve. Pa investime dhe qarkullim të mjaftueshëm të kapitalit, bie aktiviteti ekonomik. Rënia e aktivitetit ekonomik, çon në rritje të papunësisë, rënie të të hyrave tatimore dhe zvogëlime të buxheteve.

Këto zhvillime janë të lidhura drejtpërdrejt edhe me pritshmëritë dhe faktorët psikologjik. Prandaj, çdo ndërhyrje e akterëve shtetëror në ekonomi duhet të ketë parasysh këto specifika dhe të synojë rritjen e besimit në systemin ekonomik dhe në legjitimitetin e institucioneve shtetërore.

2. Zhvillimet në Kosovë

Kosova është njëri nga vendet e fundit në Europë, që është prekur nga ky virus. Kjo vjen mes tjerash edhe për shkak të pamundësisë së qytetarëve të Kosovës, që të lëvizin lirshëm përjashta. Ekonomia e Kosovës është pak e gërshetuar me zinxhirët ndërkombëtar të krijimit të vlerës, prandaj një recesion i mundshëm botëror, sikur edhe më parë, mund ta kursejë Kosovën edhe tani. Por, kjo nuk është arsye për të ulur nivelin e vigjilencës sepse recesioni mund të vije nga zhvillimet e brendshme. Masat e qeverisë për kufizimin e veprimtarive publike me qëllim të kufizimit të përhapjes së virusit Corona janë të mirëseardhura. Në anën tjetër, kufizimi i aktivitetit të brendshëm ekonomik, edhe pse i domosdoshëm, mund të ketë pasoja serioze për ekonominë, në veçanti për sektorin privat i cili qysh moti përballet me sfida të shumta.

Sektorët që po preken drejtpërsëdrejti janë ai i transportit, hotelierisë, turizmit, shërbimeve dhe deri diku ai i prodhimit. Mbyllja e kufijve dhe pamundësia e ardhjes së diasporës për pushimet pranverore apo verore, do të ndikojë negativisht në konsumin vendor. Kur dihet se

konsumi i brendshëm është njëra nga shtyllat e rritjes ekonomike në Kosovë, atëherë rënia e tij, do të ndikojë në rritjen ekonomike dhe mund të shtyjë vendin drejt recesionit.

Siç u tha më lart, gjendja aktuale në sektorin privat, edhe pa pasojat e kësaj krize, është mjaft e vështirë. Sipas studimeve të ndryshme të ECIKS, më se gjysma e ndërmarrjeve private në Kosovë janë në rrezik permanent të shuarjes, si pasojë e kufizimeve të qasjes në treg dhe financa. Po ashtu, afër 50 % e tyre nuk shohin mundësi të rritjes për shkak të kushteve të tregut, përderisa rreth 70 % për qind nuk kanë shënuar rritje të qarkullimit në tre vitet e fundit.

Mbyllja e përkohshme e shumë veprimtarive do të rëndojë edhe më shumë barrën financiare për këto ndërmarrje dhe do të përkeqësojë gjendjen e tyre, ngase ato nuk do të jenë në gjendje të gjenerojnë më të hyra gjatë kësaj periudhe, ndërsa kostot do të vazhdojnë të rrjedhin. Si pasojë, ndërmarrjet do të detyrohen të largojnë punëtorët nga puna, gjë që mund të shkaktojë edhe më shumë probleme sociale. Përpos kësaj, ato duhet të përballen me shpenzimet tjera rrjedhëse, përfshirë ato për shërbime publike, kredi, qira e deri tek obligimet tatimore. Kjo situatë mund të çojë shumë ndërmarrje drejt bankrotimit, që si pasojë mund të ketë rritjen e papunësisë dhe të varfërisë.

3. Masat e nevojshme

Për t'ju kundërvënë këtyre skenareve, qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet ekonomike e politike të vendit, duhet që krahas masave shëndetësore dhe masave tjera të njohura tashmë, të ndërmarrin edhe masat në vijim, në linjë me konceptin „*me kohë, në cak dhe përkohësisht – timely, targeted, temporary*“:

1. Të krijohet një unitet politik pozitë-opozitë për të rritur besimin në legjitimitetin e institucioneve shtetërore dhe për të mundësuar zbatimin e lehtë të të gjitha masave.
2. Të parandalohet shndërrimi i kësaj situatë në një krizë sistemike ekonomike, që mund të ketë pasoja afatgjate për ekonominë në përgjithësi, ndërmarrësinë e papunësinë në veçanti.
3. Të mbushet fondi rezervë me një shumë të konsiderueshme prej të paktën 50 milionë euro, për të siguruar likuiditetin e sektorit privat dhe për të lehtësuar qasjen në financa përmes zgjerimit të kompetencave dhe fushëveprimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.
4. Të mundësohet shtyrja e pagesës së obligimeve tatimore (TVSh-së, tatimit në fitim etj.) për të gjitha ndërmarrjet private nga sektorët e prekur për periudhën sa vlejné këto masa, pa aplikuar ndëshkime.

5. Të lirohen ndërmarrjet në fjalë prej pagesës së tatimit në të ardhurat e të punësuarve për periudhën sa vlejnjë këto masa.
6. Në bashkëpunim me sektorin bankar dhe Fondin Kosovar për Garanci Kreditore të mundësohet riprogramimi i borxheve dhe kredive rrjedhëse për të gjitha ndërmarrjet private nga sektorët e prekur për periudhën sa vlejnjë këto masa.
7. Në bashkëpunim me ndërmarrjet prodhuese e tregtare të sigurohet një furnizim i qëndrueshëm me ushqime, medikamente dhe me lëndë të parë.
8. Të rritet sasia e rezervave shtetërore, produkteve bazë të konsumit, higjienës, medikamenteve, gazit, naftës dhe derivateve të saj.
9. Të ruhet stabiliteti i çmimeve, duke luftuar rritjet artificiale e ilegale të tyre. Por, nëse rritjet e çmimeve janë të paevitueshme si rrjedhojë e ndryshimeve të theksuara të ofertës dhe kërkesës në tregun ndërkombëtar apo vendor, atëherë rritjet e këtilla që janë të paevitueshme duhet lejuar në mënyrë që të mos vije deri tek mungesa e mallrave në treg.
10. Sektori financiar i Kosovës konsiderohet si mjaft stabil. Megjithatë, në rast se vije deri te një krizë e besimit në institucionet financiare, atëherë qeveria e Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës, në bashkëpunim me Bankën Qendrore Europiane, duhet të kujdesën për sigurimin e likuiditetit të plotë të ekonomisë së vendit.

ECIKS do të vazhdojë të monitorojë gjendjen dhe sipas zhvillimeve mund të shqyrtojë dhe propozojë edhe masa shtesë. Për fund, vlen të theksohet se populli i Kosovës është i sprovuar me kriza, din të ruaj qetësinë e dinjitetin edhe në momente të vështira. Ndërsa, ndërmarrjet tona private kanë kapacitete të jashtëzakonshme për t'i absorbuar krizat, sepse janë në gjendje të përshtaten e optimizojnë, të reduktojnë apo ndërpresin përkohësisht ato aktiviteteve që ju sjellin shpenzime. Prandaj, çdo ndihmë që ato mund ta marrin sot, ato do ta kthejnë nesër me vlerë të shumëfishtë.